



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS SË MALISHEVËS



Kuvendi i Komunës

Nr.02/07

Datë: 19.01.2018

PRILJUNO:

ACCEPTED ON: 22.01.2018

PRILJUNO:

Nr.No.Br. 02/07

PROCESVERBAL

i mbledhjes së I-rë (parë) të rregulltë të Kuvendit Komunal së Malishevës

RENDI I DITËS

1. Formimi i komisionit për mbarëvajtjen e procesit të votimit, konform Udhëzimit Administrativ nr.2009/01, për procedurën e zgjedhjes dhe përgjegjësitë e kryesuesit të Kuvendit të Komunës
2. Zgjedhja e kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Malishevës komformë nenit 41 të Ligjit nr. 03/L – 040 për Vetëqeverisjen Lokale në Republikën e Kosovës

Mbledhja nuk mbahet me datë 12.01.2018, pas dy orë pritje mbledhja shtyhet për datën 15.01.2018 me kërkesën e Kryetarit të Komunës z. Ragip Begaj.

* * *

Mbledhja mbahet me datë 15.01.2018 dhe filloi në ora 10:30 të kryesuar nga anëtarja më e vjetër në Asamblenë Komunale Z. Hidajete Mazreku. Të pranishëm ishin të gjithë asambleistët, Kryetari i Komunës, drejtorë të drejtorive, OSBE, media dhe qytetarë.

Hidajete Mazreku: Përshendetje anëtarë të Asamblesë, përfaqsesit e OSBE-së, kryetarin e Komunës, qytetarët dhe juve të gjithë të pranishëm këtu! E hapi këtë seancë me dy pika të rendit

të ditës e që ju kanë ardhur juve me ftesa për mbledhje. A ka ndikush nga ju anëtarë të Asamblesë ndonjë kërkesë apo propozim lidhur me rendin e ditës apo diçka tjetër lidhur me këtë seancë? Ju lutem të deklaroheni!

Pasi që nuk ka deklarime e hudhi në votim, rendin e ditës. Kush është për për këtë rend dite?

Për: unanimitisht

Ky rend dite u aprovua unanimitisht.

Kalojmë në pikën e I-rë të rendit të ditës: Formimi i komisionit për mbarëvajtjen e procesit të votimit, konform Udhëzimit Administrativ nr.2009/01, për procedurën e zgjedhjes dhe përgjegjësitë e kryesuesit të Kuvendit të Komunës. Për formimin e këtij Komisioni duhet të jenë 3 ose 5 anëtarë. A jeni ju që ky Komision t'i ketë 3 apo 5 anëtarë?

Alban Krasniqi: Për të mos humbur më shumë kohë meqenëse përbërja e kësaj Asambleje është nga 5 subjekte politike, propozoj që secili subjekt ta ketë nga një anëtarë në përbërjen e këtij Komisioni.

Rrahim Morina: Ne e përkrahim propozimin e Albanit që Komisioni të jetë i përbërë prej 5 anëtarëve.

Hidajete Mazreku: Këtë propozim e hudhi në votim. Kush është për për përbërjen e Komisionit prej 5 anëtarësh?

Për: unanimitisht

Ky propozim u aprovua dhe ky komision do të jetë i përbërë prej 5 anëtarëve. I lus subjektet politike që të propozojnë emrat e përfaqësuesëve të tyre.

Behije Sertolli: Përshendetje për të gjithë! Përshendetje për Kryetarin dhe uroj suksese për këtë mandat dhe të gjithë anëtarëve të kësaj Asambleje!

Ne Lëvizja Vetëvendosje për këtë Komision propozojmë për anëtar Ilaz Krasniqin.

Alban Mazreku: Grupi ynë i PDK-së propozon Ali Morinën për anëtar të këtij Komisioni. Sot është një ditë e veçantë është dashur që para së të hapet mbledhja të mbahet 1 min heshtje për nderim të vrrarëve të Masakrës së Reçakut pasi që sot është përvjetori i tyre. Unë propozoj që të mbahet 1 min heshtje për përvjetorin e Masakrës së Reçakut.

Rrahim Morina: Grupi i LDK-së propozon anëtare për Komision Dianë Hoti.

Sylë Dukolli: Përshendetje për të gjithë! NISMA për këtë Komision propozon Avdi Morinën.

Hidajete Mazreku: Falemnderit për propozimet. Meqenëse AAK e ka vetëm një anëtar në Asamble atëherë ai, Kajtaz Gashi është po edhe anëtar i këtij Komisioni.

Pasi që propozuat për anëtarë të Komisionit anëtarët nga subjektet politike, tani e hudhi në votim. A jeni pro për këtë përbërje të Komisionit?

Për: unanimitisht

Meqenëse Alban Mazreku propozoi 1 min heshtje për Masakrën e Reçakut, atëherë e mbajmë 1 min heshtje.

Lavdi!

Ftoj anëtarët e Komisionit që t'i marrin pozicionet e veta dhe të gjitha përgjegjësitë që i dedikohen këtij Komisioni i mbartin këta vetë si anëtarë të Komisionit.

Kalojmë në pikën e II-të rendit të ditës: Zgjedhja e kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Malishevës komformë nenit 41 të Ligjit nr. 03/L – 040 për Vetëqeverisjen Lokale në Republikën e Kosovës.

Për të propozuar kryesues kanë të drejtë të gjitha subjektet politike, qytetarët apo ndonjë grup inicues për përzgjedhjen e kryesuesit të Kuvendit Komunal të Malishevës, por nga anëtarët e Kuvendit Komunal të Malishevës. Ftoj partitë politike që t'i japin propozimet e tyre.

Komisioni-Dianë Hoti: Ne duhet të konfirmojmë se a janë të pranishëm të gjithë anëtarët e Asamblesë, i thrras me emër dhe ata e konfirmojmë praninë e tyre me ngritjen e dorës: Arbreshë Krasniqi, Avdi Morina, Islam Vrenezi, Sylë Dukolli, Halil Morina, Luan Kryeziu, Faik Zogaj, Demir Bajra, Abetare Limaj, Sadije Krasniqi, Filloretë Bytyqi, Astrit Sertolli, Kastriot Berisha, Ali Morina, Hashim Vrenezi, Alban Mazreku, Nebih Bibaj, Florentina Zulfaj, Raimonda Krasniqi, Fjoralba Kryeziu, Hamëz Bytyqi, Rrahim Morina, Valon Krasniqi, Arlind Morina, Dianën Hoti, Leonitë Kastrati, Alban Krasniqi, Ilaz Krasniqi, Hidajete Mazreku, Behije Sertolli dhe Kajtaz Gashi.

Hidajete Mazreku: Të gjithë jemi të pranishëm, atëherë ju lutem të paraqitni propozimet e juaja për kryesues, kërkoj nga subjektet politike.

Sylë Dukolli: Ne grupi i NISMA-ës kemi pas nderin që kemi pas për bartëse të listës në këto zgjedhje një grua, një nënë e që është Arbreshë Krasniqi. Me profesion është Master e Shkencave të Psikologjisë, është një profesoreshë e nderuar dhe Malishevës i bënë nder edhe të jetë Kryesuese e Kuvendit Komunal. Pra ky është propozimi ynë.

Alban Mazreku: Ne grupi ynë i PDK-së nuk do të propozojmë asnjë kandidat për kryesues.

Valon Krasniqi: E nderuara kryesuese e mbledhjes z. Hidajete Mazreku, i nderuari Kryetar i Komunës z. Ragip Begaj, të nderuar këshilltarë të Kuvendit Komunal dhe ju të gjithë të pranishëm ju përshendes! Kam knqësinë dhe nderin që të paraqesë kandidaturën e z. Rrahim Morina për Kryesues të Kuvendit Komunal të Malishevës. Z. Morina është i lindur më 05.10.1963 në Astrazup. Shkollën fillore e kreu në Astrazup dhe Dragobil, ndërsa të mesmën në Malishevë dhe Rahovec, ndërsa Fakultetin e Edukimit në Univeristetin e Prishtinës. Në jetën politike dhe shoqërore ka bartur disa funksione: 5 mandate ka qenë Këshilltar në Asamblenë Komunale, anëtar i Komitetit për Politikë dhe Financa dhe komitete të tjera të formuara nga Kuvendi Komunal. Ka qenë drejtor për 10 vite në shkollën fillore “Ganimete Tërbeshi” në Astrazub, punëtor në Adiministratën Komunale në Malishevë dhe aktualisht punon mësimdhënës në Astrazub. Prandaj ne konsiderojmë që kandidati ynë i propozuar z. Rrahim Morina i plotëson të gjitha kushtet për ta udhëhequr Kuvendin Komunal. Falemnderit!

Hidajete Mazreku: Pas këtyre dy propozime kërkoj nga Komisioni që të përgatitën për votim dhe për këtë përgatije shkojmë për 10 min pauzë.

Pas kësaj pauze të shkurtër jemi gati që të votojmë. Republika e Kosovës, fletëvotim për zgjedhjen e kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Malishevës, janë Arbreshë Krasniqi nga NISMA dhe Rrahim Morina nga LDK. Nëse në fletëvotim votohen dy kandidatë jo votëe është e pavlefshme. Ju duhet të votoni vetëm një kandidat.

Po ju shpjegoj pak lidhur me procedurat e votimit. Votmi për zgjedhjen e kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Malishevës bëhet me vota të fshehta. Për t'u zgjedhur në rundin e parë kandidati i propozuar për kryesues duhet të marrë më shumë se sa gjysmën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Kuvendit të Komunësë. Nëse pas rundit të parë të votimit asnjëri nga kandidatët e propozuar për kryesues të Kuvendit të Komunës nuk merr më shumë se gjysmën e këtyre votave, atëherë dy kandidatët që kanë fituar numrin më të madh të votave shkojnë në votimin e dytë. Kandidati që merr më shumë se gjysmën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Kuvendit të Komunës në rundin e dytë zgjidhet kryesuesi i Kuvendit të Komunës. Nëse edhe pas votimit të dytë asnjëri nga kandidatët nuk ka fituar shumicën e kërkuar si në pikën 3 të këtij udhëzimi atëherë shkohet në rundin e tretë të votimit. Në rundin e tretë kryesuesi i Kuvendit të Komunës zgjidhet kandidati i cili merr më shumë se gjysmën e votave të anëtarëve që janë të pranishëm dhe që votojnë për propozimin në mbledhjet e Kuvendit të Komunës. Komision, urdshëroni fletëvotimet dhe thrrsini me emër me rradhë të gjithë anëtarët për të votuar.

Komisioni: Dianë Hoti: Fletëvotimet janë në rregull, mundemi me fillu me votimet e ftoj: Arbreshë Krasniqi, Avdi Morina, Islam Vrenezi, Sylë Dukolli, Halil Morina, Luan Kryeziu, Faik Zogaj, Demir Bajra, Abetare Limaj, Sadije Krasniqi, Filloretë Bytyqi, Astrit Sertolli, Kastriot Berisha, Ali Morina, Hashim Vrenezi, Alban Mazreku, Nebih Bibaj, Florentina Zulfaj, Raimonda Krasniqi, Fjoralba Kryeziu, Hamëz Bytyqi, Rrahim Morina, Valon Krasniqi, Arlind Morina, Dianë Hoti, Leonitë Kastrati, Alban Krasniqi, Ilaz Krasniqi, Hidajete Mazreku, Behije Sertolli dhe Kajtaz Gashi. Procesi i votimit mbaroi me sukses.

Tani shkojmë me numrimin e votave, secilën votë do e numrojmë me zë që të jetë më transparente, ta dëgjoni edhe ju dhe në fund të do të dalim me rezultatin e përgjithshëm nga 31 votuesit.

Rezultati i votimit:

17 vota Rrahim Morina

13 vota Arbëreshë Krasniqi

1 votë e pavlefshme

Hidajete Mazreku: E falemnderoj Komisionin për punën e tij! E ftoj Rrahim Morinën pasi që fitoi me vota të marrë detyrën e Kryesuesit për mandatin 4-vjeçar. Urime!

Rrahim Morina: Përshendetje për Kryesuesen e kësaj mbledhje z. Hidajete Mazreku, Kryetarin e Komunës z. Begaj dhe për të gjithë anëtarët e Asamblesë Komunale i përshendes dhe ju uroj sukses për këtë mandat!

Të nderuar të pranishëm i falemnderoj të gjithë ata që më mbështetën, por edhe at që s'ma kanë dhënë votën sepse kjo është demokraci!

Detyra e kryesuesit të Kuvendit nuk është privilegj por konsideroj që është një përgjegësi e madhe sepse ka të bëjë drejtpërsëdrjeti me ineteresta e qytetarëve të Komunës së Malishevës. Do të përpiqem që të jem i paanshëm dhe me dinjitet ta kryej këtë detyrë. Kërkoj nga ju që të kemi bashkëpunim, gjithaashtu edhe me Kryetarin dhe Qeverinë Komunale që të kryejmë punët me sukses. Zotohem që transparenca të jetë sa më e lartë sepse qytetari duhet ta di se nga shkon paraja dhe ndjerësa e tij. Falemnderit për votëbesim!

A dëshiron dikush falën, urdhëroni!


Kryetari-Ragip Begaj: I nderuari Kryesues urime, urime edhe juve këshilltarëve përzgjedhja e kryesuesit! Besoj që do të përpiqemi bashkë që të jemi në nivel të detyrës. Dëshiroj që të kemi bashkëpunim të sinqertë në mes vete, Kryesuesi së bashkë me ju jeni vendimmarrës. Kam bërë përpjekje që gjatë gjithë jetës sime të jem bashkëpunues me të gjithë, i falemnderoj të gjithë ata në mandatet e kaluara për punën që kanë bërë!

Ne duhet t'i mbrojmë interesta e qytetarëve sepse ata na kanë pru këtu dhe të punojmë për të mirën e vendit tonë. Unë edhe një herë ju uroj shuëm sukses juve në detyrën që keni marrë! Falemnderit!

Rrahim Morina: Ju falemnderit Kryetar! Nëse nuk ka askush më diçka për të shtuar u falemnderoj edhe një herë për mbështetje dhe zotohem që do t'u qëndroj besnik detyrës dhe përgjegjësive të kryesuesit të Kuvendit. Me kaq e mbylli këtë senacë. Falemnderit!

Mbledhja përfundoi në ora 12:00.

Procesmbajtësja
Samire Krasniqi



Kryesuesi i Kuvendit:
Rrahim Morina

